Humbja nga rënia në vlerë e aktivit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferençë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv finansiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivet e zhvlerësuara në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese

8 9

**MILSPED ALBANIA  
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE  
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

**Aktivet jo financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënien në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuara skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivit ose e njësive të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

**(g) Perfitimet e punonjesve**

*Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

*Leja e zakonshme e paguar*

Shoqeria njeh si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

**(h) Provigjonet**

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi qe të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

**(i) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

**(j) Të ardhurat nga qeratë**

Të ardhuart nga qeraja janë të ardhura të përfituar nga kontratat e qerasë, përvèc të ardhurave të kushtëzuara të qerasë të cilat njihen kur përfitohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin gjatë negocimit të një kontarate qeraje njihen si shpenzime në termat e qerasë me të njëjtat baza sit ë ardhuarat nga qeraja.

Përpjekjet për të nënshkruar një kontratë qeraje janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë aftatit të kontratës së qerasë edhe nëse këto pagesa nuk bëhen në këto baza. Afati i qerasë është një periudhë e pa anullueshme qeraje së bashku me afate të tjera të mëtejshme për të cilat qeramarrësi ka opsonin për të vazhduar qeranë, kur, në fillim të qerasë drejtimi ka një siguri të arsyeshme që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opson.

Shumat e marra nga qeramarrësi përfundimin e qerasë ose kompesimalin e përfundimit të saj njihen në pasqyrën e të ardhurave përbledhëse kur lind e drejta për ti marrë ato.

**(k) Pagesat per qeranë financiare**

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në menyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

B

10

DR

**MILSPED ALBANIA  
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE  
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

*Depozitimet e qeramarrësit*

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten më kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

**(l) Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

**(m) Kostot e huamarrjes**

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interes, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarries dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

**(n) Taksat**

Tatimi mbi fitimin nënkuption tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përvèc rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferençat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimet për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferençat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferençat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

**(o) Ngjarjet pas datës së bilancit**

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojne në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korrigueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorrigueshme.

**Informacion-Shtese per zerat sipas situates finanziare.**

Ne pasqyren e situates finanziare Aktivet, shoqeria ka paraqitur Aktivet Afatshkurter, ku bejne Mjetet monetare, Te drejta te arketueshme, Invetaret, Shpenzime te shtyra.

Gjithashtu ne Aktivet e shoqerise jane paraqitur dhe Aktivet Afatgjata, ku bejne pjese vetem Aktivet Materiale.

**MILSPED ALBANIA**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

**9. MJETE MONETARE**

Në zërin mjete monetare në vlerë prej 4,134,325 lek, janë paraqitur gjendjet e mjeteve monetare në fund të vitit në llogarite bankare të shoqërise, si dhe gjendja e mjeteve monetare në arkë.

Konvertimi i gjendjes në valutë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2015 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në valutë të huaj janë sistemuar në rezultat. Shoqeria nuk ka ekivalente te mjeteve monetare.

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës në kontabilitet përputhet me gjendjen sipas nxjerrjes së llogarive bankare. Përbërja e mjeteve monetare ne llogarite bankare dhe arke paraqitet si vijon:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Arka	17,964	3,116
Banka	4,116,360	1,125,674
<b>Totali</b>	<b>4,134,325</b>	<b>1,128,790</b>

**10. TE DREJTA TE ARKETUESHME**

Të drejtat e arkëtueshme në vlerë prej 46.212.252 lek përbehen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Të drejta të arketueshme nga aktiviteti I shfrytëzimit	8,807,724	31,557,937
Të drejta të arketueshme nga njesitë ekonomike brenda grupit	37,404,528	377,850
<b>Totali</b>	<b>46,212,252</b>	<b>31,935,787</b>

Të drejtat e arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerë prej 8,807,724 lek përbën vleren e faturave të pa arketuara nga klientet në fund të vitit 2015, të cilat përvitin ushtrimor 2015 të krahasuar me vitin e mëparshëm 2014, kanë pësuar ulje.

Ndërsa të drejtat nga njesitë ekonomike brenda grupit në vlerën prej 37,404,528 lek përbën vleren e faturave të pa arketuara nga njesitë e grupit në fund të vitit 2015.

**11. AKTIVE TE TJERA TE ARKETUESHME**

Në zërin të tjera të drejta e arkëtueshme në vlerë 322,620 lek është pasqyruar vlera e garancisë përvitje qirane e zyres, sipas kontrates.

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Garanci të dhëna	322,620	539,992
<b>Totali</b>	<b>322,620</b>	<b>539,992</b>

**12. INVENTARI**

Gjendjet e inventarëve të shoqërisë në fund të vitit ushtrimor janë vlerësuar dhe paraqitur në bilancin kontabël me metodën e kostos mesatare sipas kostove të marrjes përmjet materialet. Drejtimi i shoqërisë nuk ka ndërmarrë rivlerësimë të vlerave të inventarëve. Vlera e inventarëve përvitje vlerën e materialeve ndihmese që shoqeria i perdor përmjet aktivitetin e përditshëm të sherbimit.

Gjendja e inventarit paraqitet:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Materiale të konsumueshme	601,556	465,885
<b>Totali</b>	<b>601,556</b>	<b>465,885</b>

**MILSPED ALBANIA**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

**13. SHPENZIME TE SHTYRA**

Zëri shpenzime të shtyra paraqet shpenzimet të cilat nuk I përkasin periudhes aktuale. Ky zë përbëhet nga shpenzimet per sigurimet e aseteve të cilat perfundojnë në muajin qershor të vitit 2016

	<i>31 Dhjetor 2015</i>	<i>31 Dhjetor 2014</i>
Shpenzime të shtyra	392,907	619,029
<b>Totali</b>	<b>392,907</b>	<b>619,029</b>

**14. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Aktivet Afatgjata të shoqërisë me 31.12.2015 përbëhen vetëm nga Aktive Materiale.

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc jane të përputhura me të dhënrat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2015.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë vit ushtrimor kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësimë.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura jane te njejtë me ato që përdoren për qëllime fiskale.

Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efekte fiskale.

Në vijim paraqitet një pasqyrë në lidhje me gjendjen e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Amortizimit të tyre gjatë vitit 2015:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Aktive Afatgjata ne Proses	Makineri, Pajisje dhe Instalime	Mjete Transporti	Mobilje dhe pajisje zyre	Te tjeta aktive afatgjata materiale	Totali
<b>Vlera Bruto</b>								
<b>31.12.2014</b>	-	-	-	<b>67.878,198</b>	<b>27.202,140</b>	<b>5.075,493</b>	<b>2.441,154</b>	<b>102,596,986</b>
Shtesa	-	-	-	2,141,610	-	80,717	38,594	<b>2,260,921</b>
Transferime	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>31.12.2015</b>	-	-	-	<b>70,019,809</b>	<b>27,202,140</b>	<b>5,156,210</b>	<b>2,479,748</b>	<b>104,857,906</b>
<b>Amortizimi Akumular</b>								
<b>31.12.2014</b>	-	-	-	<b>8,229,093</b>	<b>3,626,952</b>	<b>777,292</b>	<b>375,792</b>	<b>13,009,129</b>
Shtesa	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	12,110,861	4,715,038	976,563	522,773	18,325,234
<b>31.12.2015</b>	-	-	-	<b>20,339,954</b>	<b>8,341,990</b>	<b>1,753,855</b>	<b>898,565</b>	<b>31,334,363</b>
<b>Vlera Neto</b>								
<b>31.12.2014</b>	-	-	-	<b>59,649,105</b>	<b>23,575,188</b>	<b>4,298,201</b>	<b>2,065,362</b>	<b>89,587,857</b>
<b>31.12.2015</b>	-	-	-	<b>49,679,854</b>	<b>18,860,150</b>	<b>3,402,356</b>	<b>1,581,183</b>	<b>73,523,543</b>

**MILSPED ALBANIA**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

**15. DETYRIMET**

Detyrimet e shoqërise në fund të vitit prej 63,855,575 lek përbëhen nga detyrime afatshkurtëra në vlerë prej 23,566,788 lek, si dhe nga detyrime afatgjata në vlerë prej 40,288,787 lek.

**15.1 DETYRIMET AFATSHKURTERA**

Në grupin e detyrimeve afatshkurtëra janë pasqyruar detyrimet e pagueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit, detyrimet të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit, detyrimet e shoqërisë ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore, si dhe detyrimet të pagueshme tatimore.

Detyrimet afatshkurtëra në fund të vitit 2015 të krahasuara me detyrimet afatshkurtëra në fund të vitit 2014 janë rritur në vlerë absolute prej 5,064,032 lek.

Përbërja e detyrimeve afatshkurtëra paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	16,413,016	2,806,785
Të pagueshme ndaj njësive ek.brenda grupit	4,457,909	14,665,607
Të pagueshme ndaj punonj.e sig.shoq.	783,947	628,572
Të pagueshme për detyrimet tatimore	1,911,916	401,792
<b>Totali</b>	<b>23,566,788</b>	<b>18,502,756</b>

**15.1.1 DETYRIME TE PAGUESHME PER AKTIVITETIN E SHFRYTEZIMIT**

Në zerin e detyrimeve të pagueshme nga aktiviteti i shfrytezimit në vlerë 16,413,016 lek, janë paraqitur detyrimet e shoqërise në fund të vitit per faturat e pranuara dhe të pa likujduara kryesisht për faturat e muajit dhjetor për sherbimet e blerjet e ndryshme nga të tretët.

**15.1.2 DETYRIME TE PAGUESHME NDAJ NJESIVE EKONOMIKE BRENDÀ GRUPIT**

Në zerin e detyrimeve të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit ne vlerë prej 4,457,909 lek, janë perfshire detyrimet sipas tabela te mëposhtme:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Neptun	6,500	
Tirana Logistic Park	4,451,409	14,665,607
	<b>4,457,909</b>	<b>14,665,607</b>

Detyrimi ndaj Neptun është për blerjen e aktiveve të kompanise dhe detyrimi ndaj Tirana Logistic Park është për qerane mujore të magazines.

**15.1.3 DETYRIME TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE DHE SIGURIMEVE SHOQERORE**

Detyrimet ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore në vlerën prej 783,947 lek janë paguar në muajin Janar 2016.

Përbërja e ketyre detyrimeve paraqitet si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Paga të pagueshme	134,487	134,170
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	649,460	494,402
<b>Totali</b>	<b>783,947</b>	<b>628,572</b>



**MILSPED ALBANIA**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**  
(Vlerat ne ALL)

**15.1.4 TE PAGUESHME PER DETYRIMET TATIMORE**

Në zërin e detyrimeve të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerë prej 1,911,916 lek janë paraqitur detyrimet ndaj tatimeve të cilat janë paguar në muajin janar 2016.

Tatimi mbi të ardhurat e punonjësve, tatimi në burim Jane të barabarta sipas listë pagesave të deklaruara për muajin Dhjetor 2015. Detyrimi për Tvsh paraqet shumën e pageses sipas FDP-se të muajit dhjetor 2015.

Ndersa Detyrimi për tatim fitimin është shuma e përllogaritur sipas Pasqyres së performances, duke zbritur këstet e parapaguara gjatë vitit.

Keto detyrime përbëhen si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Tatim mbi të ardhurat personale	249,827	175,460
Tatimi mbi Fitimin	601,664	226,332
Shteti – Tvsh për tu paguar	1,053,005	-
Tatime në burim	7,420	-
<b>Totali</b>	<b>1,911,916</b>	<b>401,792</b>

**16. DETYRIMET AFATGJATA**

Në grupin e detyrimeve afatgjata shoqeria ka paraqitur vetëm detyrimin për huatë.

**16.1 HUATE AFATGJATA**

Në zërin e detyrimit ndaj institucioneve të kredisë është paraqitur vlera e kredisë në fund të vitit sipas planamortizimit në vlere prej 40,288,787 lek. Kjo hua është marrë nga shoqëria për qëllim investimi në makineri dhe paisje në vitin 2014.

Vlera e huase e krahasuar me vitin e mëparshem paraqitet si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Huamarrje të tjera afatgjata (Leasing )	40,288,787	49,527,529
<b>Totali</b>	<b>40,288,787</b>	<b>49,527,529</b>

**17. KAPITALI DHE REZERVAT**

Në grupin e kapitalit dhe rezervave shoqëria ka paraqitur kapitalin e nënshkruar, si dhe fitimet e pashpërndara të vitit finanziar.

**17.1 KAPITALI I NENSHKRUAR (Aksionar)**

Në zërin e kapitalit të nënshkruar shoqeria me 31 dhjetor 2015 ka paraqitur kapitalin e regjistruar në vlerë 56,108,000 ose ekuivalenti në EUR 400,000 dhe zotërohet nga dy ortakë me pjesemarrje të barabarte prej 50% secili.

Ortaku shoqeria "Balfin" zoteron 50% të kuotave, ose në vlerë 28,054,000 lek (ekuivalenti në EUR 200,000),

Ortaku shoqeria "Milsped Doo" zoteron 50% të kuotave, ose në vlerë 28,054,000 lek (ekuivalenti në EUR 200,000).

Kapitali i shoqërise gjatë vitit 2015 nuk ka pësuar ndryshime.

Tabela e mëposhtëme paraqet strukturën e ortakëve të shoqërise dhe kontributin e tyre .

**MILSPED ALBANIA  
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE  
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

NR.	Zotërues të kapitalit	Nr. I kuotave	Kapitali i Ortakëve		
			Date 31/12/2015		
			Vlera Nominale në lek	Vlera totale e kapitalit në lek	Struktura ne %
1	Balfin Shpk	50	280,540	28,054,000	50%
2	Milsped Serbia Doo	50	280,540	28,054,000	50%
	<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>561,080</b>	<b>56,108,000</b>	<b>100%</b>

## 17.2. FITIME TE PASHPERNDARA DHE FITIM/HUMBJE TE VITIT

Në zërin e fitim/humbjeve shoqëria ka paraqitur fitimet e pashpërndara të mbartura në vlerë prej 139,056 lek, si dhe fitimet e vitit finanziar të vitit 2015 në vlerë prej 5,084,572 lek.

## 18. TE ARDHURA NGA VEPRIMTARIA E SHFRYTEZIMIT

Gjatë vitit 2015 shoqëria ka realizuar të ardhura nga shitjet e shërbimeve të magazinimit,distribucionit, sherbimeve doganore dhe organizimit të transportit ndërkombëtar.

Të ardhurat (shitjet) e deklaruara gjatë vitit me librat e shitjes, janë paraqitur në pasqyrën e performancës për vitin ushtrimor, duke u korrektuar për vlerën e autongarkesës prej 3,082,806 lek, sipas ligjeve fiskale në fuqi.

Të ardhurat sipas përberjes paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Magazinim-Distribucion	87,984,187	78,415,417
Shërbime Doganore	9,708,249	1,639,782
Organizim transporti ndërkombëtar	27,893,826	-
Shitje mallrash	44,285,999	-
Të ardhura te tjera	148,036	-
<b>Totali</b>	<b>170,020,297</b>	<b>80,055,199</b>


## 19. SHPENZIME PER LENDE E PARA DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME.

Në zërin e shpenzimeve lënde të parë dhe materiale të konsumit në vlerë prej 42,860,639 lek shoqëria ka paraqitur vlerën e disa mallrave që ka patur në ruajtje, dhe në baze të kushteve të krijuara kontraktuale i ka blere dhe i ka shitur menjëherë në vlerë totale prej 42,583,336 lek, ndërsa vlera e materialeve të konsumuara gjatë vitit 2015 është në vlerë prej 277,303 lek .

Blerjet e materialeve të konsumushme (për aktivitetin) gjatë vitit kanë qenë prej 412,974 lek , gjendja në fillim e materialeve është prej 465,885 lek, ndërsa gjendja në fund të vitit është prej 601,556 lek.

Lëvizjet e materialeve e mallrave është paraqitur në zelin e aktivit “Inventare”.

	<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>31 Dhjetor 2014</b>
Blerje mallra gjatë vitit	42,583,336	1,689,788
Blerje material të konsumushme gjatë vitit	412,974	25,926
<b>Totali i blerjeve gjatë vitit</b>	<b>42,996,310</b>	<b>1,715,714</b>
Ndryshimi i gjëndjeve të inventarit	(135,671)	(465,885)
<b>Kosto e mallrave e materialeve të përdorura</b>	<b>42,860,639</b>	<b>1,249,829</b>

  
VLADIMIR MKOJEVIC

**MILSPED ALBANIA**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

**20. SHPENZIMET E PERSONELIT**

Në zërin e shpenzimeve të personelit në vlerë gjithsej prej 29,189,575 lek është paraqitur vlera e pagave bruto sipas listë pagesave, si dhe vlera e shpenzimeve për kontributet shoqërore e shëndetesore të perballuara nga punëdhënesi.

Përberja e shpenzimet për personelin paraqitet si më poshtë:

	<i>31 Dhjetor 2015</i>	<i>31 Dhjetor 2014</i>
Paga	25,552,548	17,444,633
Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	3,637,027	2,471,658
<b>Totali</b>	<b>29,189,575</b>	<b>19,916,291</b>

**21. SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT**

Shpenzimet janë njohur mbi bazen e konsumit dhe në funksion të aktivitetit të shoqërise, per të gjeneruar të ardhura.

Shpenzimet(blerjet) e deklaruara gjatë vitit me librat e blerjes, janë paraqitur në pasqyren e performancës për vitin ushtrimor, duke u korrektuar për vleren e autongarkesës prej 3,082,806 lek, sipas ligjeve fiskale në fuqi.

Perberja e shpenzimeve të tjera të shfrytëzimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	<i>31 Dhjetor 2015</i>	<i>31 Dhjetor 2014</i>
Shpenzime për energji elektrike/ujë	2,306,491	1,787,922
Trajtime të përgjithshme	165,195	238,613
Qera	23,043,630	23,650,203
Mirëmbajtje dhe riparime	1,661,337	1,650,164
Shpenzime për Siguracione	1,214,661	1,014,434
Sherbime të tjera( roje objekti, serv comput,ligjore)	4,139,444	5,317,695
Shpenzime për publicitet, reklama	320,033	3,500
Transferime, udhëtime, dieta	661,064	951,727
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,640,248	1,240,661
Shpenzime transporti	4,747,163	4,971,752
Shpenzime për sherbime bankare	709,222	473,491
Taksa dhe tarifa vendore	85,620	57,585
Shpenzime të tjera	1,643,937	-
Transport Ndërkombëtar	26,682,881	-
Shpenzime për pritje dhurata	260,468	363,822
Blerje/Shpenzime të tjera për kancelari	439,256	629,147
Gjoba	55,471	105,406
<b>Totali</b>	<b>69,776,121</b>	<b>42,456,122</b>

Duke analizuar përbërjen e shpenzimeve të shfrytezimit, rezulton se peshën specifike më të madhe në këtë grup e zenë shpenzimet e qirasë rrëth 33%, si dhe shpenzimet për transport rrëth 38%.

**22. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA INTERESI**

**MILSPED ALBANIA**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

	<i>31 Dhjetor 2015</i>	<i>31 Dhjetor 2014</i>
Shpenzimet nga interesë	(4,051,351)	(2,636,196)
Fitim nga interesat	155	13,184
<b>TOTALI</b>	<b>(4,051,196)</b>	<b>(2,623,012)</b>

Shpenzimet e interesit përfshijnë interesin që i takon kredisë nga Banka Societe Generale e cila përdoret për të paguar makineritë dhe paisjet në magazinën e shoqërise.

### **23. FITIM (HUMBJET) NGA KURSI I KEMBIMIT**

Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit paraqesin humbjet e vërtetuarë gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në valutë të huaj. Si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve, të drejtave e detyrimeve qe ka shoqeria në fund te vitit në monedhe të huaj.

Përberja e shpenzime/ardhura nga këmbimet paraqitet si më poshtë:

	<i>31 Dhjetor 2015</i>	<i>31 Dhjetor 2014</i>
Të ardhura nga kursi kembimit	995,566	326,782
Shpenzime nga kursi i kembimit	(613,909)	(691,010)
<b>Totali</b>	<b>381,656</b>	<b>(364,228)</b>

### **24. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN**

Në fund të vitit 2015 shoqeria ka bëre perllogaritjet për Shpenzimi i tatim fitimit duke bere korrektimin e tij për shpenzimet e panjohura.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 eshte 15%. Niveli taksimit për fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2014 ka qënë 15%. Në vlerë detyrimi I tatim fitimit të llogaritur për vitin ushtrimor ështe 1,114,616 Lekë.

Më poshtë jepet pasqyra e llogaritjes së tatim fitimit:

	<i>Viti 2015</i>	<i>Viti 2014</i>
<b>Fitim kontabel i vitit 2015</b>	<b>6,199,188</b>	<b>436,588</b>
<b>Shpenzime te pazbritshme</b>	<b>1,231,588</b>	<b>1,256,830</b>
<i>Shpenzime me fatura jo te rregullta tatimore</i>	1,176,117	1,151,424
<i>Gjoba dhe kamat vonesa</i>	55,471	105,406
<b>Fitimi Fiskal per vitin 2015</b>	<b>7,430,776</b>	<b>1,693,418</b>
Humbje te mbartura nga viti 2014	-	(51,200)
<b>Fitimi Fiskal per vitin 2015</b>	<b>7,430,776</b>	<b>1,642,218</b>
<i>Tatim fitimi 15%</i>	1,114,616	246,332
<b>Fitimi neto Kontabel</b>	<b>5,084,572</b>	<b>190,256</b>

### **25. PALET E LIDHURA**

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me shoqërite e saj mëmë Balfin sh.p.k, Milsped Doo si edhe me kompanitë e saj. Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

Ne shtojcat bashkelidhur gjenden palët e lidhura.



**MILSPED ALBANIA  
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE  
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

(Vlerat ne ALL)

**26. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

**HARTUESI**

*Kontabilisti I Shoqerise*

*Ergjina Gole  
Ergjina Gole*

**ADMINISTRATORI**

*Marjeta Gole  
Marjeta Gole*

*Vladimir Mlodjevic  
Biljanka*

